

## Republika e Kosovës: Deklarata përfundimtare e Misionit Konsultativ 2011 për Nenin IV

Maj 30, 2011

*Kosova gëzoi një rritje të fuqishme në vitet 2000 dhe përballoi krizën globale financiare mjaft mirë. Megjithatë, ekonomia varet nga dërgesat nga jashtë (remitancat) dhe investimet direkte nga diaspora kosovare, një model i rritjes që mund të jetë i paqëndrueshëm. Forcimi i konkurrencës përmes reformave administrative dhe ligjore, infrastruktura më e mirë, dhe kufizimi i pagave-janë të nevojshme për të nxitur lindjen e një sektori të tregtueshëm dhe rritjen e vetë-qëndrueshme. Politika fiskale adreson presionet për rritjen e kapitalit dhe shpenzimeve sociale nga një bazë e të ardhurave të kufizuara. Në aspektin afat-shkurtër, është i rëndësishëm ekzekutimi i disiplinuar i buxhetit. Në aspektin afat-mesëm kërkohet një ri-orientim i prioriteteve fiskale, duke përfshirë edhe ngritjen e të ardhurave nga taksat e drejtpërdrejta. Sistemi financiar është zhvilluar me shpejtësi, por ka ruajtur një strukturë të shëndoshë të financimit.*

### Historiku

**1. Në dekadën e kaluar, Kosova ka shënuar përparim të rëndësishëm me ndërtimin e institucioneve kryesore sociale dhe ekonomike.** Përpjekjet për të ndërtuar funksionet bazë të një administrate publike dhe forcimin e qeverisjes kanë përfituar nga ndihma të konsiderueshme të jashtme.

**2. Kosova gëzoi rritje të fuqishme ekonomike në 2000, me strukturën e rritjes drejt kërkesave vendore.** Remitancat nga Kosovarët që jetojnë jashtë vendit kanë rritur konsumin, ndërsa investimet e huaja direkte kanë shtuar aktivitetet ndërtimore. Përkundrazi, sektori i eksportit ka mbetur i vogël. BPV për kokë banori mbetet ndër më të ultit në Evropë. Sfida të mëdha sociale, me papunësi të vlerësuar rreth 40 për qind të fuqisë punëtore.

**3. Kosova në mënyrë unilaterale adoptoi euron si valutë legale.** Ndërkohë që kjo mbështet stabilitetin duke importuar një spirancë të fortë monetare dhe i ka shërbyer ekonomisë në përgjithësi, ajo vendos një premium për makro-politikat e disiplinuar, nivelet konkurruese të pagave, dhe fleksibilitetin për t'ju pershtatur goditjeve të jashtme përmes përshtatjes së brendshme.

**4. Sistemi financiar u zgjerua shumë shpejt në dekadën e fundit, por evitoi rregullimin e disbalancave të mëdha të financimit.**

Bankat janë kryesisht në pronësi të huaj dhe të financuara nga depozitat. Përkrahur nga asistencë teknike, banka qendrore (BQK), ka marrë përsipër përgjegjësinë për mbikëqyrjen financiare dhe është duke ndërtuar kapacitetet për të siguruar ndihmë emergjente likuiditeti për sistemin bankar.

**5. Kosova përfiton nga borxhi i ulët publik dhe mbulesë e konsiderueshme e parave të gatshme të qeverisë, si rezultat i një politike konservative fiskale për shumicën e viteve 2000.**

Potenciali për zgjerim ishte kufizuar nga një bazë tatimore e kufizuar dhe nga pamundësia e qeverisë për të dhënë borxh. Shpenzimet publike si përqindje e PBV-së janë modeste, pjesërisht për shkak të shpenzimeve të ulta për transfertat, pasi që shumica e skemave të sigurimeve shoqërore janë rindërtuar kryesisht pas vitit 1999. Në përgjithësi, Kosova nuk bart barrën e madhe të detyrimeve afatgjata për pensionistët, veteranët, apo kreditorët.

## **Zhvillimet e fundit**

### **6. Kriza financiare globale ka pasur një ndikim të vogël në Kosovë,**

pasi që integrimi i kufizuar në tregjet globale financiare dhe të mallrave frenoi 'infekcionin'. Inflacioni ndjek zhvillimet e çmimeve për importet e ushqimit dhe benzinës, duke shkaktuar deflacion në 2009 dhe inflacioni dy shifror në fillim të 2011. Vazhdoi rritja e moderuar e kredisë por cilësia e portofolit të bankave u përkeqësua në menyrë modeste ndërsa profiti vazhdoi të jetë solid. Mbulesat e mëdha të kapitalit sugjerojnë një kapacitet të mjaftueshëm për absorbimin e goditjeve.

### **7. Që nga viti 2008, qeveria ka miratuar një qëndrim fiskal tejte ekspansionist, financimin e deficiteve nga mbulesa me para të gatshme, shitjet e aseteve, dhe përkrahjen e donatorëve.**

Bilanci i përgjithshëm qeveritar ka lëvizur nga një tepricë prej më shumë se 7 për qind të PBV në 2007 për një deficit prej 2.6 për qind në vitin 2010. Shpenzimet kapitale ka qenë shtytja kryesore e zgjerimit. Në 2010, filloi ndërtimi i një autostradë që lidh Prishtinën me kufirin shqiptar. Shpenzimet janë vlerësuar në më shumë se 20 për qind të PBV vjetor. Këtë vit, presionet e shpenzimeve u zgjeruan në shpenzimet aktuale, me rritje të mëdha në pagat e sektorit publik dhe përfitimet e lidhura me luftën.

### **8. Një marrëveshje 18-mujore Stand-by (SBA) e miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FMN në korrik 2010 u ndërpre në vitin 2011.**

Programi që synon rikthimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, duke ushtruar shtërngimin e shpenzimeve aktuale dhe forcimin e depozitave të qeverisë në BQK. Elementet e buxhetit -2011, në veçanti rritja e madhe në faturën e pagave- kanë devijuar nga marrëveshja e programit. Si rezultat, asnjë program rishikimi nuk mund të përmbushet. Gjatë këtij misioni, stafi dhe autoritetet kanë arritur marrëveshjen në nivel të stafit për një Program për monitorimin e Stafit për të krijuar një historik që mund të çojë në një marrëveshje të mbështetur nga FMN-në 2012.

## **Perspektiva afatshkurtër dhe rreziqet makroekonomike**

### **9. Perspektiva afatshkurtër është e mirë, edhe pse çmimet e larta të ushqimit po ushtrojnë presion mbi inflacionin.**

Remitancat, ndikojnë në rritje të fuqishme të kredisë, ndërsa investime publike vazhdojnë të mbështesin kërkesat e brendshme. Eksportet po rriten shpejt, edhe pse nga një bazë e ulët. Ekonomia e përgjithshme pritet që të shënoj rritje me rreth 5 për qind në 2011 dhe 2012. Çmimet e larta të importit pritet të shtyjnë inflacionin në më shumë se 8 për qind (mesatarja vjetore) gjatë këtij viti. Megjithatë, inflacioni bazë mbetet i mirë, edhe pse ndikimet e mundshme nga pagat e larta në sektorin publik duhet të shikohen. Stafi i FMN parasheh rritje të deficitit të llogarisë rrjedhese deri në 25 për qind të PBV-së, të financuar nga IHD dhe flukse të tjera që nuk krijohen nga borxhi.

## **10. Perspektiva do t'i nënshtrohet rreziqeve të mëdha të reduktimit nga burimet e brendshme dhe të jashtme.**

Rreziqet e brendshme përfshijnë hapat e gabuar të politikave ekonomike dhe trazirat politike. Rreziqet e jashtme përfshijnë një rritjen më të dobët në Europë. Kjo mund të pakësojë të ardhurat e kosovarëve që jetojnë jashtë vendit, duke kufizuar kështu remitancat dhe hyrjet e kapitalit, dhe duke detyruar një tkurrje në kërkesën e brendshme. Dërgesat e ulta mund të ndikojnë edhe në sistemin bankar, duke ulur depozitat, si dhe në kapacitetin e debitorëve për të permbushur detyrimet e tyre.

### **Nxitja e konkurrencës dhe promovimi i rritjes së qëndrueshme**

#### **11. Modeli i rritjes së Kosovës kërkon riorientim.**

Deri me tani rritja është mbështetur në remitancat jashtëzakonisht të larta dhe IHD-ve nga jashtë, por perspektivat afat-gjata për këto flukse janë ndrydhur pasi që kosovarët nga diaspora janë integruar më shumë në vendet ku jetojnë. Nëse shohim tutje, sfida kryesore është inkurajimi i një sektori të tregtueshëm që mund të nxitë zhvillimin dhe rritjen ekonomike.

#### **12. Kufizimet e shumta pengojnë zhvillimin e një sektori të tregtueshëm.**

Infrastruktura mungon, sidomos në fushën e transportit dhe të furnizimit me energji. Kapaciteti i kufizuar administrativ dhe gjyqësor pengojnë klimën e biznesit. Nivelet e aftësive të pjesës më të madhe të fuqisë punëtore janë modeste, duke pasqyruar *ndër të tjera* ndërprerje në ofrimin e arsimit para pavarësisë. Pagat, edhe pse të ulta në terma nominal, nuk janë veçanërisht konkurruese kur shkallëzohen sipas matjeve të produktivitetit (si PBV për kokë banori).

#### **13. Strategjia për konkurrencën e miratuar së fundi nga ana e qeverisë përmban hapa të rëndësishëm në drejtimin e duhur,**

reformat sidomos administrative dhe ligjore për të përmirësuar rangimin e Kosovës në studimin "Doing Business" të Bankës Botërore; privatizimi i prodhimit dhe shpërndarjes të energjisë për të rritur besueshmërinë e furnizimit me energji; dhe

programi ambicioz i qeverisë për ndërtimin e autostradës, edhe pse ngarkesat e ndërlidhura fiskale kërkojnë menaxhim të kujdesshëm.

#### **14. Duhet të shmangen implikimet negative të politikave qeveritare për koston e punës.**

Rritja e mprehtë e pagave në sektorin publik mund të shkaktoj efekte të padëshirueshme në pagat e sektorit privat. Pagat minimale duhet të jetë vendosur në nivelet që shmangin përjashtimin e punonjësve e veçanërisht të rinjëve nga punësimi formal.

#### **Rivendosja e qëndrueshmërisë fiskale**

#### **15. Politika fiskale duhet të mbetet e ankoruar në dy objektiva plotësuese: ruajtjen e likuiditetit adekuat dhe qëndrueshmërinë e borxhit publik.**

- *Amortizatorët (mbulesa) e Likuiditetit* përbëhet kryesisht nga bilancet e qeverisë në BQK. Ata janë të nevojshëm jo vetëm për të permbushur nevojat e likuiditetit të qeverisë, por edhe të zgjas burimet për BQK-në për të siguruar ndihmë emergjente të likuiditetit për bankat nëse është e nevojshme. Një kriterium mates i dobishëm për bilancin e mjaftueshëm të bankës janë një muaj i shpenzimeve publike, plus një e dhjeta e detyrimeve jo-kapitale të bankave, duke iu shtuar rreth 300 milion €.
- *Qëndrueshmëria e borxhit.* Stafi i FMN rekomandon caktimin e deficitit primar afat-mesëm prej rreth 0.5 për qind të PBV-së. Kjo do të lejonte një rritje shumë graduale të borxhit publik, duke stabilizuar rreth 30 për qind të PBV-së në aspektin afat-gjatë. Ligji për borxhin publik i Kosovës parashikon maksimum e raportit të borxhit publik si 40 për qind të PBV-së, kështu që, shtegu i rekomanduar i deficitit lë hapësirë për të reaguar ndaj goditjeve apo të rritjeve të jashtme.

#### **16. Konflikti aktual fiskal i Kosovës me të dy objektivat.**

Menaxhimi i likuiditetit është komplikuar nga shpenzimet e mëdha për autostradën gjë që sjell rritje të deficitit të përkohshme për rreth 5 për qind të PBB-së, me mundësi të kufizuar të financimit përmes dhënies së borxhit. Për sa i përket qëndrueshmërisë, stafi ka përlogaritur që deficitit primar për buxhetin e vitit 2011 të jetë 3 ½ për qind e PBB-së, duke nënkuptuar një nevojë për rregullim fiskal prej afërsisht 3 për qind të PBB-së.

#### **17. Në mënyrë të veçantë, kur sfidat fiskale të vitit 2011 duken të menaxhueshme, të rregullueshme dhe / ose u nevojiten pagesat e jashtme për të parandaluar bilancet bankare të bien nën nivelet e lejuara në 2012-tën.**

Të hyrat kanë evoluar mirë, duke reflektuar pjesërisht progres me mbledhjen e taksave. Megjithatë, rritja aktuale e pagave për shërbimin civil rit shpenzimet në mënyrë permanente për rreth një për qind të PBB-së. Në buxhetin e 2011 kjo rritje është

kompensuar pjesërisht nga shpenzimet e ulëta kapitale. Të ardhurat nga privatizimi i operatorit të postës dhe telekomit pritet të jetë burimi kryesor i financimit të deficitit. Ndërsa privatizimi duket se është në plan të finalizohet para fundit të vitit, një shtyrje e mundshme përbën rrezik, ndaj stafi i FMN-së rekomandon krijimin e një rezervë sigurie. Në gjysmën e dytë të 2012, bilancet bankare janë parashikuar të jenë të varfëruara me politika të pandryshuara.

**18. Kundrejt kësaj situate, stafi i FMN-së rekomandon rregullim fiskal të ¾ për qind të PBB-së çdo vit për një periudhë prej katër vitesh,**

me një përzjerje të masave të ardhurave dhe kufizim të shpenzimeve aktuale. Një politikë e tillë do të mbrojë të dyja likuidimin adekuat të mbulesës dhe një qëndrim të qëndrueshme fiskale, me kusht që ndihma ndërkombëtare rifillon në 2012.

**19. Nisma e re e shpenzimeve duhet të jetë kosto e thellë, dhe kjo nismë kërkon të ardhura më të larta ose shkurtimet e shpenzimeve diku tjetër. E rëndësishme është që , qeveria ka në plan një tjetër autostradë, atë nga Prishtina në Shkup / Maqedoni, për të cilën një plan i shëndoshë financimi është një parakusht i domosdoshëm. Prioritetet sociale përfshijnë pensione për veteranët e luftës dhe përfitime për ish të burgosurit politikë. Para projektimit të përfitime të tillë, nevojitet një vlerësim i saktë i numrit të përfituesve të ligjshëm.**

**20. Më gjerësisht, planet ambicioze të qeverisë për shpenzime sugjerojnë nevojën për një riorientim të prioriteteve fiskale.**

Financimi i shpenzimeve më të larta me të ardhura të njehershme është i paqëndrueshëm nëse nevoja për shpenzim është e përhershme. Në këtë rast, nevojiten më shumë të ardhura të përhershme. Një mundësi është ngritja e fitimit të ulët nga taksat e drejtpërdrejta. Një mision i ardhshëm për asistencë teknike i FMN- së do të zhvillojë rekomandime në bashkëpunim me autoritetet.

**21. Metodat jo konformiste të financimit duhen shmangur.**

Në mënyrë të veçantë, qeveria nuk duhet të caktojë mjetet e fondit pensional Shtylla II, edhe pse një pjesë modeste e të hyrjeve të reja mund të investohen në letra me vlerë të qeverisë brenda kufijve të kuadrit ligjor aktual. Huamarrja pa koncesion në shkallë të gjerë duhet shmangur. Ndërkohë që veprime të tilla mund ta zbusin kufizimet afat-shkurtër, në afat të mesëm ata do të bëjnë më të vështirë financimin e buxhetit.

**Ruajtjen e stabilitetit financiar**

**22. Ndërkohë që sistemi financiar i Kosovës ka evoluar në një mënyrë të fuqishme, progresi i mëtejshëm pengohet nga kapaciteti i kufizuar gjyqësor dhe mos-kompletimi i të drejtës së pronës.**

Me ndihmën e Bankës Botërore, autoritetet janë duke përmirësuar një kadastër për të rritur përdorimin dhe të nxitur cilësinë e kolateralit në operacionet e kreditimit. Reformat për përsheptimin e zbatimit të kontratës nga ana e gjykatave janë gjithashtu të

nevojshme.

**23. Pavarësia e plotë institucionale dhe operacionale e BQK-së është e domosdoshme për ruajtjen e stabilitetit financiar.**

Në këtë kontekst, emërimi i një guvernatori të ri të bankës qendrore në fillim të këtij viti u karakterizua nga një zbatim i pastër i rregullave për nominim të ligjit të bankës qendrore.

**24. Mbikëqyrja Financiare ka bërë progres.** Duke ndjekur një model të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik në kuadër të Bazel I, krye qëllimi është të realizohet çdo vit të paktën të paktën një inspektimit i plotë në teren për çdo bankë. Përparime janë duke u bërë edhe në fushën e testimit të stresit gjithashtu.

**25. Miratimi i ligjit të ri për sistemin bankar do të forcojnë kornizën institucionale për bankat dhe institucionet mikrofinanciare.**

Projektligji përmirëson standardet e qeverisjes, forcon kufizime për kreditimin ndaj palëve të ndërlidhura me bankat, dhe lejon mbikëqyrjen e konsoliduar ndaj grupeve bankare. Ajo gjithashtu ofron mjetet më të mirë të autoriteteve si zgjidhje bankare. Për këtë qëllim, ligji për sigurimin e depozitave duhet të ndryshohet për të lejuar që fondet e sigurimit të depozitave të përdoren për blerje dhe transaksione të mundshme. Për sa i përket institucioneve mikrofinanciare, ligji duhet të kërkojë një strukturë të përcaktuar qartë të pronësisë dhe ti caktojë BQK-së përgjegjësinë për licencim.

**26. Një përparësi i mundëson BQK-së të sigurojë në rast nevoje ndihmë emergjente për likuiditet (NEL).**

Si koncept NEL u prezantua në vitin 2010. Duke shkuar drejt, një memorandum mirëkuptimi në mes të qeverisë dhe BQK-së gjë që duhet të përfundojë për të përcaktuar detyrat dhe identifikojnë burimet që BQK-ja mund të përdorni për NEL.

\*\*\*\*\*

*Dëshirojmë që të falënderojmë autoritetet për mikpritjen e tyre dhe për diskutimet e hapura dhe konstruktive.*

**DEPARTAMENTI PËR MARËDHËNIE ME JASHTË I FMN**

**Marrëdhënie me Publikun**

E-mail: [publicaffairs@imf.org](mailto:publicaffairs@imf.org)

Fax: 202-623-6278

**Marrëdhënie me Mediat**

Tel: 202-623-7100

Fax: 202-623-6772

